

VENDIM

I Asamblesë se Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë “ELAID“ Sh.p.k

Në Tiranë , sot më datën 4 December 2020, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e ortakëve të Shoqërisë “ELAID“ Sh.p.k me zotërues 100% të Kuotave të kapitalit të shoqërisë ortakët:

- I. Ortaku themelues **Z.Elis Xherahu**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 51.000(pesëdhjet e një mijë) Lekë që përben **51 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- II. Ortaku themelues **Z.Aida Troka**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 49.000(dyzet e nëntë mijë) Lekë që përben **49 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
E cila do shqyrtoj me rend-dite si më poshtë vijon:

Rend Dite:

1. Krijimin e Shoqërisë “ELAID“ Sh.p.k
2. Regjistrimi i Statutit të Shoqërisë “ELAID“ Sh.p.k pranë Qendrës Kombëtare të Bisnesit.

Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë, pasi diskutoi me çështjet e përcaktuara në rendin e ditës.

VENDOSI:

1. Krijimin e Shoqërisë “ELAID“ Sh.p.k
2. Regjistrimi i Statutit të Shoqërisë “ELAID“ Sh.p.k pranë Qendrës Kombëtare të Bisnesit.
3. Ngarkohet **Znj.Aida Troka** si administratore e Shoqërisë “ELAID“ Sh.p.k të kryejë pranë Qendrës Kombëtare të Bisnesit si cdo procedurë të nevojshme ligjore dhe administrative për regjistrimin e këtyre vendimeve.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ortakët.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE TË SHOQËRISË

“ELAID“ SH.P.K

ORTAKËT

Z.Elis Xherahu

Znj. Aida Troka

STATUTI
“ELAID“ Sh.P.K

STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ELAID“ Sh.p.k

Sot më datë 4 December 2020 , duke u bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit" i ndryshuar, në të nënshkruarit shprehim vullnetin tonë të lirë dhe të plotë, për të nënshkruar këtë statut me qëllim krijimin e shoqërisë "ELAID" Sh.P.K si më poshtë vijon;

KREU I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

NENI 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1.1 Sot, në datë 4 December 2020, Ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "ELAID" SH.P.K

1.2 Themeluesit e shoqërisë janë :


- I. **Z.Elis Xherahu** , i biri i Rajmond, i datëlindjes 09/04/1983, lindur në Tiranë, dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar me karte identitetit Nr. Personal I30409141R.
- II. **Znj. Aida Troka** e bija e Gezim-it e datëlindjes 18/12/1983, lindur në Mat dhe banues në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, e identifikuar me karte identitetit Nr. Personal I36218034L.

1.3 Të cilët kanë vendosur krijimin e shoqërisë dhe miratimin e statutit të ri të shoqërisë në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë veçanërisht sipas Ligjit 9901 dt 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe si person juridik të zhvillojnë aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 2
Objekti

2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

- Qëndër Estetike SPA, masazheri, fizioterapi.sherbime mjekesore dhe dermoestetike. Ofrimi i sherbimeve te ndryshme si: manikyr, pedikyr, pastrim dhe trajtim fytyre, duarsh dhe kembesh.
- Import eksport , tregti me shumicë dhe me pakicë produktesh kozmetike dhe farmaceutike.
- Ushtrimin e aktivitetit tregtar ne fushen e shitjes se produkteve kozmetike, aksesoreve dhe veshjeve duke u licensuar si pike shitje ekskluzive ose zyrtare i markave



nderkombetare dhe luksoze. Hapjen e dyqaneve ekskluzive monomarke te produkteve kozmetike, aksesoreve dhe veshjeve.

- Për të arritur objektivat e saj, shoqëria mund të marrë pjesë, të asociojë, të bashkëpunojë me kompani, ndërmarrje të përbashkëta dhe përgjithësisht persona juridikë ose fizikë, vendas ose të huaj, në procedura prokurimi publik (tendera) te organizuara nga institucione shtetërore, ligjin publik ose privat, duke ndjekur të njëjtin qëllim ose të ngjashëm.
- Objekti i shoqërisë mund të ndryshoje, të zgjerohet ose të pakësohet në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.
- Shoqëria, me vendim të Administratorit dhe bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme me miratim te oratkëve, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.
- Shoqëria mund të kryejë cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

NENI 3

Kohëzgjatja

3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pa caktuar , duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakëve të shoqërisë.

NENI 4

Selia

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Rruga “Mustafa Matohiti”**, prane Bar Lounge “NAGA” , Tiranë Albania K.P. 1000.

4.2 Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:

Email : e_troka@hotmail.com ;

KREU II

Neni 5

Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është *100.000,00 (Njëqind mijë) Lekë (*sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë*)*. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- I. Ortaku themelues **Z.Elis Xherahu**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 51.000(pesëdhjet e një mijë) Lekë që përben **51 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- II. Ortaku themelues **Z.Aida Troka**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 49.000(dyzet e nëntë mijë) Lekë që përben **49 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

5.2 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

NENI 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

6.1 Kapitali i shoqërise mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar dhe licensuar për keto kontribute me vendim asambleje të shoqërisë sipas kërkesës së administratorit.

6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit, vendimet merrën me 2/3 e kuotave pjesëmarrëse

6.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, ndërsa për persona të tjerë jashtë shoqërisë do të funksionojë e drejta e parablerjes, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

7.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

- 8.1 Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.
- 8.2 Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 8.3 Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 8.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 8.6 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 9.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

9.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10 **Kuorumi**

10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrësë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 **Marrja e vendimeve**

11.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12 **Përrjashtimi nga e drejta e votës**

12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

12.1 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 **Administrimi**

13.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

13.2 Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

13.3 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

13.4 Personi i mëposhtëm caktohet si Administratore e parë e shoqërisë identifikuar ;

- **Znj. Aida Troka e** bija e Gezim-it e datëlindjes 18/12/1983, lindur në Mat dhe banues në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar me karte identitetit Nr. Personal I36218034L.

a. **Specimenti Firmës**

Neni 14 **Kompetencat e Administratorëve**

14.1 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një brenda paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

14.2 Administratoret janë të detyruar të therasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuarve 7renda 3 muajve në vazhdim.

- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër 7renda, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

- shoqëria, 7renda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

14.3 Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

14.4 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbelimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

15.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

15.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

15.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

15.4 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

15.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

15.6 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

15.7 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

15.8 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

16. Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

17.1 Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet

periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

17.2 Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

18.1 Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;

d) me vendim të gjykatës;

18.2 Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

18.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

18.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket me vendim asambleje

18.5 Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

19.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vedimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 20

Baza Ligjore

20.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

20.2 Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

21.1 Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"ELAID" Sh.P.K

Z.Elis Xherahu

Elis Xherahu

Znj. Aida Troka

Aida Troka

"ELAID"

SH.P.K